



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KACANIKUT OPŠTINA KACANIK	
1. Dati	Vendi	
26-11-18	Kosanik	
Nr. doli.	Numri	Shtojce
	01 9061-3545	/



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

KONTRATA PËR SHËRBIME

Komuna e Kaçanikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga z. Shefket Kokha – Menaxher i prokurimit; në njëren anë dhe

NNSH"AS-CONSTRUCTION" (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga Arton Zeqiri ne anën tjeter, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

"Hartimi i Projektit kryesor të kanalizimit fekal në f. Semajë"

kontratë njëvjeçare me numër identifikues KA652/18/110/236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të **"Hartimi i Projektit kryesor të kanalizimit fekal në f. Semajë"**.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 27.11.2018

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 10 dite nga data e nënshkrimit të kontratës

1.4 Vendi i **Komuna Kaçanik**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Cmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **663.00€; (Gajshteqinegjashtdhjetëeuro, 00/100€)**.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendorur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vlefshme pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përgjashim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Në llog. Bankare 2032000078433287 TB Prishtinë.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën e detyrimeve pas pranimit të punëve nga ana e Menagjerit dhe komisionit për pranim te punëve.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të leshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debloqohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i Shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të përgjegjësuar specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të jetë deri një vit pas pranimit të punëve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonje ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonje ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonje ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë. Autoriteti Kontraktues, pa njofitim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së përfundimit të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marja e njofimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjerin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sëbas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afalin e caktuar; c) Refuzon urdhurat administrativ të autoritës kontraktues; d) I jep dikujt kontratën apo

nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë pér një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata pér mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje pér të kryer një pjesë materiale të kontratës pér më shumë se 180 ditë, pér arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore pér zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit se kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën komunale në Kaçanik në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jep Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen Shqip në tri origjinalë, dy origjinalë pér Autoritetin Kontraktues dhe një original pér Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Artan Zeqiri	Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	Pronar	Pozita:	Menaxher i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	16.11.2017	Data:	26.11.2017
Vula:		Vula:	

PARAMASA ME PARALLOGARI
PËR HARTIMI I PROJEKTIT KRYESOR PER SHTRIRJEN E RRIJETIT TË KANALIZIMIT FEKAL PËR
VENDBANIMIN E FSH. SEMAJË - KAÇANIK

NR.	EMËRTIMI I POZICIONIT	INJESIA	SASIA	Ç. INJESI	TOTALI
	Hartimi i projektit kryesor sipas detyrës projektuese.				
1	Llogaria të bëhet për m'. Llogaria të bëhet për m'.	m'	1950	0.34	663.00
			SHUMA TOTALE:	663.00 €	

Kaçanik, 04.10.2018

E punoi: DUKMM